

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Eros dhe tendera me hije korrupsioni në UKT. Klientët dge skema nuk ndryshon. Drejtori i ri Flauers Sho shi shton pasuritë e dyshimta. Skerdi Drenova nis pastrimin e parave si konsulent financiar?
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/21/eros-dhe-tendera-me-hije-korrupsioni-ne-ukt-klientet-dge-skema-nuk-ndryshon-drejtori-i-ri-flauers-shoshi-shton-pasurite-e-dyshimta-skerdi-drenova-nis-pastrimin-e-parave-si-konsulent-financiar/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:02:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 15:01:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	721f8f6764735616be51885a136097e3c3633c8c69dda3b3bb8cf0b963431a2f
TEKSTI	9dc781ecf81dba84f64c9ec4f22b527787b3bf8e0969e9ff4f65f13c476c26da
PAMJA	52f956f949fa60e1084507a51c01d2e0277a27b4c8f15dd3820686f2621b8990

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cc9a33f5e22b745544e0571e506dac62d8f91e2fbeecc7d462777df439bbaeb1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cc9a33f5e22b745544e0571e506dac62d8f91e2fbeecc7d462777df439bbaeb1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Eros dhe tendera me hije korrupsioni në UKT. Klientët dge skema nuk ndryshon. Drejtori i ri Flauers Shoshi shton pasuritë e dyshimta. Skerdi Drenova nis pastrimin e parave si konsulent financiar?

Investigim

Publikuar: 21/09/2026

f X



Largimi i drejtorit 'hamshor' Skerdi Drenova bashkë me 'hirushet' e tij nuk i kanë shuar thashethemet për historitë rozë dhe harbimet në Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT), një nga institucionet simbol për afëra të dyshuara korruptive me tendera, shpenzime të fryra dhe shpërdorime. Një tjetër histori dashurie përflitet vesh më vesh, herë me nënqeshje dhe herë me romuze në UKT, duke i dhënë institucionit publik të ujit konturet e një lokacioni erosi.

(Nuk është sekret që ministritë dhe drejtoritë janë kthyer në hapësira që shërbejnë për të përmbushur "takime të afërta" e "nevoja personale". Korridoret e tyre shërbejnë si kthina pub-i për njohje të reja. Për vajzat e shumta në korridoret e administratës, dita kalon me takime të vogla private, nëpër zyra, korridore, holle, deri në një ambient më të qetë të zyrës së "shefave", ku bëhen "takime pune". Hapësirat dhe aromat janë

Me te lexuarat

Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë \$

"Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te

Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tendera n...

dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te

Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

shumë ndjellëse në korridoret e ministrive, aty ku hierarkitë dhe detyrat shtetërore zbehen përpara dëshirave apo epsheve të fshehta).

Megjithatë, tenderat, koncensionet, lejet dhe licencat janë në plan të parë. Në fund të muajit dhjetor 2025 u shkarkua nga detyra kreu i Ujësjiellës-Kanalizimeve Tiranë, Skerdi Drenova, i cili kur drejtonte OST, përpos shumë bëmave të tjera, hapi edhe një tender me vlerë 130 mijë euro për trajtim kozmetik për punonjëset femra. Fiksimin për të shpërdoruar paratë publike e jetësoi edhe në UKT, ku hodhi idenë për kontrollin emocional të punonjëve.

Ideja e Drenovës u konkretizua nga drejtori i ri Flauers Shoshi, me përvojë në çështjet e furnizimit me ujë, i cili në korrik 2026 hapi tenderin me vlerë 120 mijë euro. Shoshi u emërua në krye të UKT në 5 janar 2026. 'Goditjen e parë' Shoshi e bëri në 19 janar 2026 duke i dhënë Erzen Breçanit tenderin me vlerë rreth 2.5 milionë euro për shoqërimin me roje të parave që mbledhin pikat e UKT-së dhe ruajtjen fizike të godinave.

Sipas burimeve, tenderi ishte paracaktuar me pazar në tavolinë nga Drenova dhe Breçani, të cilin SPAK-u e akuzon për grup kriminal, trafik droge dhe pastrim parash. Nuk ka pasur konkurrencë, pasi me konkurrentët ishte marrë vesh fituesi. Oferta fituese është pothuajse sa fondi limit. Letrat ishin kopsitur. Shoshit i është dashur vetëm finalizimi. Dhe ashtu ndodhi. Shoshi ka 'qerasur' me dy tendera 300 mijë euro për zhbllokim pusetash edhe demokratit tjetër Sahit Dollapin, që të dy me ofertë sa fondi limit.

Krahas tenderave të zakonshëm, të cilët i 'fitojnë' i njëjti rreth klientelist, Flauers Shoshi ka bërë një tjetër 'goditje të madhe', me tenderin e blerjes së tubave, me vlerë 1.5 milionë euro, paracaktuar për Ajla Ngjeliun. Tenderi u hap me 5 mars 2026, ndërsa fituesi u shpall një muaj më vonë, me ofertë gati sa fondi limit. Pjesë e manipulimit të procedurës është edhe kompania Ligus shpk.

Para se të emërohej në UKT, Flauers Shoshi ka qënë kreu i Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve. Ky funksion i ka sjellë edhe kosto pasi emri i tij është në një dosje të SPAK-ut për tenderin 15 milionë euro për ndërtimin e një Eco-Parku në zonën e Porto Romanos. Nga ana tjetër, pas emërimit AKUM, Shoshi rezultoi se është pronar i tetë pasurive të paluajtshme, me burim herë kursimet nga paga dhe herë si dhuratë.

Skerdi Drenova kërçdinë me tendera, dyshohet se fsheh pasuri miliona euro

Evidenca, lidhje dhe disa raporte të KLSH-së konfirmojnë se Skerdi Drenova ka bërë kërçdinë me tendera kur ishte në krye të OST-së dhe UKT-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë një auditimi të

Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), kur në krye ishte Drenova, ka kosntatuar vjedhje të fondeve publike nga disa kompani, të cilat ishin kontraktuar nga OST përmes procedurave tenderuese (të dyshuara si fiktive) për zbatimin e kontratave për shërbime të ndryshme, si mirmëmbajtje, shtrirje linjash etj.

Krahas tenderave për verë, mish, lule dhe ditëlindje, Drenova i dha rreth 300 milionë lekë kompanisë ASG me pronar Gazmend Haxhia për makina me qira, ndërkohë që me këto para mund të bliheshin 15-20 makina të reja. Të njëjtën skemë Drenova aplikoi edhe në UKT, duke finalizuar tendera të paracaktuar për një rreth klientësh, të cilët, siç shprehen disa prej tyre, jepnin në këmbim ryshfet 20-30 përqind.

Vështirë të besohet se Drenova diktonte vetë ndarjen e tendera të mëdhenj duke marrë ‘pjesën e luanit’, por Drenova dyshohet se ka bërë miliona euro thjeshtë duke u kujdesur për kopsitjen e letrave. Drenova ka deklaruar disa apartamente dhe tokë në Borsh, ndërsa pas shkarkimit nga UKT ka nisur të lëshojë fatura si konsulent financiar.

Konsulencë teknike në fushën e teknologjisë, inxhinierise dhe tregut financiar

TAG: Eros Flauers shoshi Ost Skerdi drenova Tendera Ukt

Të ngjashme

Mbushi Europën me drogë / Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga “kokat” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

Çifti Brunilda Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, AKU mjaftohet me një gjobë ndaj kompanisë INITALY ...

500 mesazhe / “Do përfundojmë keq shpirt”. Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te Gys Agasi për takimet me krerët e shërbimeve partnere dhe sur...

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike,

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION **DOSJE ROZË**
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

mediave të njësuar me interesat
klienteliste, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.